



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, (FSHE) shpall konkurs për 2 (dy) pozicione pune, personel akademik me kohë të plotë, të kategorive:

- 1 (një) kandidat të kategorisë profesor
- 1 (një) kandidat të kategorisë lektor

**I. Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë profesor janë si më poshtë:**

**I.1. Kriteret e përgjithshme të kategorisë profesor**

1. Kandidati duhet të mbajë titullin profesor;
2. Titulli akademik i lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse e për Arsimin në Shqipëri;
3. Kandidati të ketë përfunduar studimet akademike (Doktor, Master i Shkencave dhe Bachelor) dhe ose ekuivalente me të, në profilin, edukim fizik;
4. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian,
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
6. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

**I. 2. Kriteret të veçanta për kandidatit e kategorisë profesor janë si më poshtë:**

1. Të ketë kryer specializime të thelluara në Shkencat Sportive;
2. Të ketë botime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkuar;
3. Të ketë mbi 5(pesë) vite përvojë pune në IAL;
4. Të ketë qenë/jetë aktiv në fushën e trajnimit sportiv;
5. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

**II. Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë lektor janë si më poshtë:**

**II.1 Kriteret e përgjithshme të kategorisë lektor:**

1. Kandidati duhet të jetë i kategorisë lektor;
2. Grada shkencore e lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse e për Arsimin në Shqipëri;
3. Kandidati të ketë përfunduar studimet e thelluara akademike në fushën e teorisë, metodikës së edukimit fizik dhe trajnimit sportiv;
4. Kandidati të ketë përfunduar studimet akademike në profilin edukim fizik;
5. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian;
6. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
7. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

**II.2 Kriteret e veçanta të kategorisë lektor:**

1. Të ketë kryer botime shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkuar
2. Të ketë mbi 5(pesë) vite përvojë pune në mësimdhënie në IAL;
3. Të ketë kryer një nga ciklet e studimit në një nga vendet BE-së;
4. Të ketë qenë/jetë aktiv në fushën e trajnimit sportiv;
5. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të puns në grup;
6. Të ketë rekomandime/referenca nga punëdhënës të mëparshëm.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)).
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
5. Kopje e librezës së punës/vërtetim punësimi nga punëdhënësi për ekperiencën e punës
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti).
8. Raport i aftësisë për punë.
9. Fotokopje e letërnjoftimit.
10. Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (27.01.2025 - 05.02.2025) nga data e shpalljes në [www.unie.edu.al](http://www.unie.edu.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,**

**Aplikim për pozicionin e punës:** *personel akademik, Edukim Fizik dhe  
Sporte- FSHE*  
**Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (07.02.2025 – 19.02.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.